



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale  
Ministarstvo Rada i Socijalne Zastine  
Ministry of Labour and Social Welfare

Departamenti për Punë dhe Punësim Department of Labor  
and Employment Departament za Rad i Zaposljavanje

### **Kush pajiset me vërtetim për lajmërim të punës deri në gjashtëdhjetë (60) ditë?**

Vërtetimit për lajmërimin e punës, deri në gjashtëdhjetë (60) ditë brenda një (1) viti, mund të punojnë të huajt si vijon:

Ofruesit e shërbimeve të revizioneve dhe konsulencës;

Ligjëruesit që marrin pjesë në tubimet dhe seminarët e organizuar profesional;

Artistët dhe personeli teknik, për shfaqjet e operave, baletit, teatrit, koncerteve dhe shfaqjeve tjera kulturore, respektivisht autorët dhe ekzekutuesit në fushën e artit të filmit dhe televizionit;

Punëtorët në parqet e cirkut dhe ato zbavitëse.

### **Kush pajiset me vërtetim për lajmërim të punës deri në tridhjetë (30) ditë?**

Vërtetimit mbi lajmërimin e punës, deri në tridhjetë (30) ditë gjatë vitit, mund të punojnë shtetasit e huaj siç vijon: Autorët dhe ekzekutuesit në fushën e muzikës, muzikës së skenës dhe artit të vallëzimit

si dhe ekzekutuesit përcjellës, personeli teknik;

Në shfaqjet e panairit dhe ekspozitës, në të cilat ekzekuton punëdhënësi i tyre.

### **Ku duhet te paraqitet i Huaji se Pari?**

I huaji së pari duhet të paraqitet në Drejtorinë për Migrim dhe të Huaj/Policia e Kosoves ku duhet ta deklaroj Hyrjen dhe qëllimin e hyrjes në Republikën e Kosovës.

### **Pse i Huaji duhet te paraqitet ne DMH?**

Drejtoria për Migrim dhe të Huaj njofton zyrtarisht Departamentin e Punës dhe Punësimin për paraqitjen e të huajit me qëllim të punës dhe vendbanimit të përkohshëm.

### **Ku mund te Aplikon një i Huaj për Vërtetimin për Lajmërimin e Punës?**

Aplikimi për Vërtetimin për Lajmërimin e Punës (30; 60 apo 90 ditë) bëhet vetëm në Departamentin e Punës dhe Punësimin -MPMS.

### **Sa duhet të pritët për pajisje me Vërtetim për Lajmërimin e Punës?**

Për pajisje me Vërtetim për Lajmërimin e Punës procedura zgjat deri në tri ditë.

### **Kush nuk ka nevojë të Pajiset me Vërtetimin mbi Lajmërimin e Punës?**

Nëse shtetasit e huaj, të cilët në Republikën e Kosovës paraqiten në shfaqjet dhe garat sportive, si përfaqësues të ekipeve, klubeve të jashtme ose reprezentacioneve shtetërore, nuk kanë nevojë të pajisen me Vërtetimin mbi Lajmërimin e Punës.

### **Sa eshte Taksa Administrative për pajisje me Vërtetim për Lajmërimin e Punës?**

Në bazë të Vendimit të Ministrit të MPMS për Taksën Administrative për Vërtetim për Lajmërimin e Punës deri në nëntëdhjetë (90) ditë, pagesa është 90 €; Vërtetim për Lajmërimin e Punës deri në gjashtëdhjetë (60) ditë pagesa është 60 €; Vërtetim

për Lajmërimin e Punës deri në tridhjetë (30) ditë, pagesa është 30€.

### **Cilat janë kriteret për marrjen e vërtetimit për lajmërim të punës?**

- 1.1.** Dokument të vlefshëm udhëtimi;
- 1.2.** Kontratën e punës sipas ligjit të punës në Republikën e Kosovës;
- 1.3.** Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- 1.4.** Dëshminë mbi arsimimin, kualifikimin e fituar dhe aftësimin e të huajit;

Kur kemi të bëjmë me punë në OJQ duhet të sillt certifikata e regjistrimit të OJQ-së.

Në rastet kur kemi të bëjmë me punë vullnetare, i huaji duhet të plotësoj:

- Dokument të vlefshëm udhëtimi;
- Dëshminë për regjistrimin e organizatës;
- Konfirmimin nga organizata për punë vullnetare;

# UDHËZUES

## PËR PAJISJEN ME VËRTETIMIN PËR LAJMRIMIN E PUNËS

Të drejtat dhe detyrimet e të huajve në Republikën e Kosovës janë rregulluar me Ligjin për të Huajt Nr. 04/L219 dhe akteve nënligjore që burojnë nga ky ligj <http://www.mpb-ks.org>.



# KUSH ËSHTË I HUAJ NË KOSOVË?

I huaj është çdo person fizik i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës.

## OBLIGIMET E TË HUAJIT?

Çdo shtetas i huaj obligohet që gjatë lëvizjes dhe qëndrimit të tij në Republikën e Kosovës t'i përmbahet legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

## KUSH PAISET ME VËRTETIM PËR LAJMËRIMIN E PUNËS?

Të huajt të cilët punojnë në fusha të caktuara deri në nëntëdhjetë (90) ditë, deri në gjashtëdhjetë (60) ditë dhe deri në tridhjetë (30) ditë brenda një viti duhet të paisen me këtë vërtetim për lajmërimin e punës.

Në bazë të vërtetimit për lajmërimin e punës, i huaji mund të punojë për të njëjtin punëdhënës ose marrësin e shërbimeve, në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

### Adresa dhe kontakte:

DEPARTAMENTI I PUNËS DHE PUNËSIMIT

**Adresa:** Rr Uçk Nr.1

**Tel:** +381 (38) 213 678; Centrix 26144;

**Fax:** +381 38 212 018

<http://mpms-ks.org>

# Kush pajiset me vërtetim për lajmërim të punës deri në nëntëdhjetë (90) ditë?

## Vërtetimit për lajmërimin e punës, deri në nëntëdhjetë (90) ditë brenda një (1) viti, mund të punojnë të huajt si vijon:

- Përfaqësuesi tregtar, personeli kryesor dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës të shoqërisë tregtare, të cilët i kryejnë punët për shoqërinë tregtare, por nuk janë në marrëdhënie pune;
- Ofruesit e shërbimeve në turizëm, përfaqësuesit turistik, respektivisht animatorët në pajtim me dispozitat e posaçme;
- Shkencëtarët në aftësimin shkencor dhe profesional, shkencëtarët –përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, shkencëtarët që do të marrin pjesë në realizimin e projekteve shkencore, të rëndësishëm për Republikën e Kosovës;
- Personeli udhëheqës, ekspertët, arsimtarët dhe ligjëruesit e institucioneve të jashtme kulturore, arsimore dhe shkencore, të cilët në Republikën e Kosovës i kryejnë punët në kuadër të programeve të bashkëpunimit kulturor dhe arsimor, si dhe personeli udhëheqës, ekspertët, arsimtarët dhe ligjëruesit arsimore dhe shkencore, të cilët në Republikën e Kosovës i kanë shoqatat e veta, nëse vijnë nga institucioni amë;
- Zyrtarët civil dhe ushtarak të qeverive të shteteve tjera, të cilët në Republikën e Kosovës vijnë të punojnë në bazë të kontratës së bashkëpunimit me Qeverinë e Republikës së Kosovës;
- Korrespondentët e jashtëm, të akredituar në Republikën e Kosovës ose reporterët e medieve të huaja;
- Përfaqësuesit dhe personeli i bashkësive fetare, të cilët i kryejnë punët ekskluzivisht të lidhura me shërbimin fetar mirëbërës;

- Studentët, të cilët në unionet ose institucionet e Kosovës vijnë për punë vullnetare në kampet punuese ose në programet arsimore dhe të punës, respektivisht, të cilët vijnë në praktikë në misionet diplomatike dhe konsullore, të akredituara në Republikën e Kosovës;
- Vullnetarët, të cilët punojnë në unionet dhe institucionet jo fitimprurëse në Republikën e Kosovës në pajtim me dispozitat e posaçme, respektivisht në bazë të programeve të shkëmbimit dhe bashkëpunimit vullnetar;
- Shtetasit e huaj, të cilët në Republikën e Kosovës vijnë ta kryejnë stazhin ushtrimor në shoqëritë tregtare, shoqatat ose përfaqësitë, të cilët janë pronarë të firmës tregtare të jashtme, nëse ata të huaj vijnë nga ajo firmë në seli, respektivisht nga përfaqësia ose shoqata e saj në një shtet tjetër;
- Të huajt që i kryejnë punët e mbikëqyrjes dhe inspeksionit të riparimit dhe ndërtimit të anijeve, respektivisht të huajt që i kryejnë punët e mbikëqyrjes ose inspeksionit të prodhimit, të pajisjeve montazhe, të makinerisë dhe instrumenteve tjera, në bazë të kontratës mbi eksportimin ose porosinë e porositësit të huaj;
- Të huajt që e kryejnë praktikën, aftësimin ose punën vullnetare në kuadër të Programit të Bashkëpunimit, Programit për mësim gjatë tërë jetës dhe Programit të Rinjëve në Veprim, pastaj të programeve dhe iniciativave tjera, të cilat i zbaton organi i arsimit dhe shkencës;
- Ekspertët në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, të letërsisë dhe arkivave;
- Të huajt, që kryejnë mësimin profesional, aftësimin dhe shkollimin e të punësuarve të personat fizik dhe juridik në Republikën e Kosovës;
- Të huajt, të cilët i kryejnë punët e lidhura me porositë, montazhet ose servisimin e makinave ose pajisjeve, ndërsa puna e tyre është kusht për realizimin e të drejtave të tyre garantuese ose është e lidhur me porosinë e makinerisë ose pajisjeve;
- Të huajt, të cilët aftësohen profesionalisht të personi juridik me seli në Republikën e Kosovës, i cili është i lidhur me punëdhënësin e jashtëm;
- Nxënësit, të cilët përmes të organizatës së autorizuar ose përmes të programit të shkëmbimit të nxënësve vijnë në praktikë.